



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**PARIMET PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHFRYTËZIMIN E SISTEMIT TË  
TRANSMETIMIT DHE TREGUT SI DHE TAKSAVE TË KYÇJES**

Prishtinë, Janar 2017



Pjesa I – Dispozitat e përgjithshme		3
Neni 1	Qëllimi dhe Fushëveprimi	3
Neni 2	Përkufizimet	3
Pjesa II – Parimet e përbashkëta		5
Neni 3	Mos diskriminimi dhe pasqyrimi i kostos	5
Neni 4	Thjeshtësia dhe transparencë	5
Pjesa III – Metodologjia e përcaktimit të tarifave për transmetim		6
Neni 5	Metodologjia e përcaktimit të tarifave për transmetim	6
Neni 6	Baza e përcaktimit të tarifave	6
Neni 7	Ndarja e tarifave për transmetim	6
Neni 8	Përcaktimi i tarifave për OST/OT	7
Neni 9	Oferta e Kushteve për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit	8
Pjesa IV – Kyçja në sistem		9
Neni 10	Metodologjia e përcaktimit të taksave	9
Neni 11	Kyçja e gjeneratorit	10
Neni 12	Taksat për kyçje	10
Neni 13	Përcaktimi i taksave për kyçje	11
Neni 14	Oferta e Kushteve për kyçje	11
Pjesa VI - Dispozitat e kalimtare dhe përfundimtare		12
Neni 15	Dispozitat kalimtare	12
Neni 16	Gjuha zyrtare	12
Neni 17	Ndryshimet	12
Neni 18	Shfuqizimi	12
Neni 19	Interpretimi	12



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas autoritetit të dhënë me nenin 9, paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1.5, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenin 47 paragrafi 3 nënparagrafin 3.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr 05/L-084), dispozitat e nenit 16 paragrafi 1.16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr 05/L-085), në seancën e mbajtur me datë 18.01.2017, miratoi:

**PARIMET PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHFRYTËZIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT DHE TREGUT SI DHE TAKSAVE TË KYÇJES**

**PJESA I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Parimet mbi të cilat OST duhet të hartojë “Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit”, Metodologjia e Tarifave SHST.
2. Parimet mbi të cilat OS duhet të hartojë “Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit”, Metodologjia e Tarifave OS.
3. Parimet mbi të cilat OT duhet të hartojë “Metodologjitë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Tregut”, Metodologjia e Tarifave OT.
4. Parimet mbi të cilat OST/OT duhet të hartojë “Metodologjinë për përcaktimin e taksave për kyçje në sistemin e transmetimit”.
5. Metodologjitë e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni pas hartimit të tyre do të dërgohen në ZRRE për aprovim.
4. Parimet duhet të jenë në përputhje me Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, dhe me Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe të tregut të nxjerrura nga ZRRE.

**Neni 2**

**Përkufizimi**

1. Shprehjet e përdorura në këtë dokument kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1 “Aplikuesi (parashtruesi i kërkesës)” do të thotë një person fizik apo juridik i cili i kërkon



OST/OT-së të bëjë kyçjen e re apo për të modifikuar kyçjen ekzistuese në sistemin e transmetimit;

- 1.2 “Kyçje e Thellë” nënkupton se parashtruesi i kërkesës do të ofroj me shpenzimet e veta apo do të paguaj kostot e aseteve të nevojshme për kyçje në pikën më të afërt të përshtatshme të kyçjes në sistemin ekzistues të transmetimit plus çfarëdo kostosh indirekte që shkaktohen nga punë të ndërlidhura me përforcimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues e të cilat shkaktohen si pasojë direkte e operimit të pikës së kyçjes;
  - 1.3 “Kapaciteti Efektiv” nënkupton kapacitetin total në secilën pikë të rrjetit i cili është në dispozicion për t’u shfrytëzuar nga shfrytëzuesit pa cenuar kufizimet teknike të operimit të rrjetit. Mund të klasifikohet duke iu referuar çfarëdo kriteri teknik përkatës apo standardeve në fuqi duke përfshirë por duke mos u kufizuar në, kapacitetin aktual të bartjes, kapacitetin e lidhjes së shkurtër, kufijtë e tensionit apo kufijtë e stabilitetit;
  - 1.4 “Kyçje e Cekët” nënkupton se parashtruesi i kërkesës do të ofroj me shpenzimet e veta apo do të paguaj vetëm ato kosto që shkaktohen nga krijimi i një kyçjeje të re në pikën më të afërt të përshtatshme të rrjetit ekzistues të transmetimit të përcaktuar nga operatori i sistemit të transmetimit.;
  - 1.5 “Shfrytëzuesi” ka kuptim siç është e përcaktuar me Kodin e rrjetit;
  - 1.6 “SHST” nënkupton Shfrytëzimi i Sistemit të Transmetimit;
  - 1.7 “OS” nënkupton Operatori e Sistemit;
  - 1.8 “OT” nënkupton Operatori i Tregut;
2. Të gjitha shprehjet tjera të përdorura në këtë dokument do të kenë kuptimin në bazë të ligjeve të sektorit të energjisë.



## **PJESA II – PARIMET E PËRBASHKËTA**

### **Neni 3**

#### **Mos diskriminimi dhe pasqyrimi i kostos**

1. Metodologjitë për përcaktimin e tarifave dhe taksave të paraparë në Nenin 2 më lartë, OST/OT duhet të ngarkojë ose ofroj të ngarkojë me çmim cilindo furnizues ose konsumator për ndonjë kyçje apo shfrytëzim të sistemit , të cilat:
  - a) nuk janë diskriminuese dhe të ndryshme në aspektin material dhe teknik në mes të konsumatorëve të cilët parashtrajnë kërkesë për shërbim të ngjashëm; dhe
  - b) pasqyron, në masë të arsyeshme, kontributin që jep konsumatori i tillë për kostot e përgjithshme të ofrimit të shërbimit të kërkuar.
2. Metodologjitë për përcaktimin e tarifave dhe taksave për kyçje për OST/OT-në, duhet të reflektojë kostot e secilit të licencuar. Pas aplikimit të tarifave apo taksave përkatëse, OST/OT duhet të mbulojnë kostot nga cilado kategori e shfrytëzuesve, përfshirë edhe kostot e investimeve, të cilat OST/OT i ka dëshmuar se mund t'i atribuohen asaj kategorie.

### **Neni 4**

#### **Thjeshtësia dhe transparenca**

1. Tarifat dhe Taksat duhet të jenë sa më të thjeshta, transparente dhe të parashikueshme.
2. Tarifat dhe Taksat duhet të reflektojnë nevojën për optimizim të shfrytëzimit të rrjetit dhe të pasqyrojë shpenzimet e shkaktuara për kyçje dhe shfrytëzim të sistemit nga shfrytëzues të caktuar.
3. Tarifat dhe Taksat duhet të marrin parasysh zhvillimet e ardhshme në strukturën e sektorit të energjisë elektrike dhe të lejojnë rregullim më të sofistikuar krahas zhvillimit të tregut.



## **PJESA III – METODOLOGJITË E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE PËR TRANSMETIM**

### **(METODOLOGJITË SHST, OS DHE OT)**

#### **Neni 5**

##### **Metodologjitë e Përcaktimit të Tarifave për Transmetim**

1. Metodologjitë për përcaktimin e tarifave duhet t'iu mundësojë shfrytëzuesve të sistemit që të bëjnë një vlerësim të arsyeshëm mbi tarifën e aplikueshme për shërbimet e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe të operatorit të tregut dhe duhet të përfshijë:
  - a) Bazën mbi të cilën do të llogariten tarifën për kategoritë e ndryshme të shfrytëzuesve;
  - b) Bazën mbi të cilën do të caktohen tarifën e veçanta për kapacitetin në nivelet e ndryshme të tensionit në sistemin e transmetimit;
  - c) Listën e çfarëdo tarifave që mund të kërkohen për ofrimin dhe instalimin e çdo njehsori, përfshirë njehsorët kontrollues, apo ndonjë impianti elektrik në pikat hyrëse apo dalje, të cilat ndihmojnë dhe janë të domosdoshme për lejimin e shfrytëzimit të sistemit dhe për mirëmbajtjen e njehsorëve apo impianteve të tilla;
  - d) Kriteret mbi të cilat merret vendimi i OST-së për të refuzuar qasje në sistem, të cilat duhet të jenë objektive, dhe teknikisht e ekonomikisht të arsyetuara.

#### **Neni 6**

##### **Baza e përcaktimit të tarifave**

1. Në përcaktimin e tarifave për shfrytëzuesit për përdorimin e sistemit sipas paragrafit 1 të Nenit 5, OST duhet të merr parasysh kostot afatgjata të mirëmbajtjes të sigurt dhe të besueshëm të sistemit në mënyrë që të përmirësohet parashikueshmëria, stabiliteti dhe pasqyrimi i kostos së çmimeve në aspektin afatgjatë.
2. Metodologjitë për përcaktimin e tarifave për shfrytëzim të sistemit, duhet të marrin parasysh kostot afatgjate, marginale, kostot e shmangura të rrjetit që shkaktohen nga masat për menaxhimin e kërkesës.

#### **Neni 7**

##### **Ndarja e tarifave për transmetim**

1. OST duhet ti mbulojë tarifën e SHST përmes një koeficienti prej 0% ndaj gjenerimit dhe 100% ndaj ngarkesës.



2. OST duhet t'i mbulojë tarifat për shërbimet e operatorit të tregut dhe operatorit të sistemit përmes një koeficienti ndarës ndaj gjenerimit dhe furnizimit, varësisht prej pjesëmarrjes së tyre në sasinë e energjisë në transmetim:

a. Kur nga ky alokim, rezulton që çmimi mesatar vjetor i tarifës së transmetimit të paguar nga gjeneratori të jetë më i madh se 0.5 €/MWh, atëherë alokimi në tarifat e OT dhe OS duhet të azhurnohet në atë mënyrë që tarifa mesatare e paguar nga gjeneratori nuk do të tejkaloj vlerën prej 0.5€/MWh.

3. Tarifa për fondin e burimeve të ripërtëritshme, e cila do të mbulohet nga furnizuesit në mënyrë proporcionale sipas pjesëmarrjes në tregun e energjisë elektrike.

4. Tarifat duhet të përcaktohen në mënyrën e cila mundëson diferencimin e kostos për ofrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit, të disponueshëm në nivele të ndryshme të tensionit.

## Neni 8

### Përcaktimi i tarifave për OST/OT

1. Tarifat për shfrytëzimin e rrjetit, operimin e sistemit dhe tregut të cilat do t'i ngarkohen palëve në treg duhet të mbulojnë:

- a) Kostot kapitale, kostot e mirëmbajtjes së sistemit për operim të sigurt dhe të besueshëm të sistemit në përputhje me standardet kombëtare në fuqi që vlejnjë për transmetimin e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, dhe atë deri në masën ku këto kosto nuk mund të rikthehen nga ndonjë tarifë apo taksë tjetër;
- b) Kostoja e mirëmbajtjes së tensionit dhe frekuencës në kuadër të kufijve siç është detajuar në Kodin e Rrjetit;
- c) Kostoja e arsyeshme e humbjeve në transmetim në formën e furnizimeve shtesë të nevojshme për t'i mbuluar këto humbje në transmetim (siç përcaktohen nga Rregullatori);
- d) Kostoja e instalimit dhe mirëmbajtjes së matjeve relevante, deri në masën ku këto kosto nuk mund të rikthehen nga ndonjë ngarkesë tjetër; dhe
- e) Çfarëdo kosto tjetër të cilën, kohë pas kohe, Rregullatori mund ta aprovojë si të rikthyeshme përmes sistemit të tarifave ashtu siç përcaktohet në Rregullin e Çmimit të OST-së.

2. Shfrytëzuesit nuk duhet të paguajnë për kostot kapitale, operative apo të mirëmbajtjes në lidhje me asetet në nivele të tensionit të cilat nuk i shfrytëzojnë.



## Neni 9

### Oferta e Kushteve për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit

1. Në kërkesën e parashtruar nga ndonjë konsumator, OST duhet të ofrojë marrëveshje për ofrimin e shfrytëzimit të shërbimeve të sistemit.
2. Oferta në paragrafin 1 duhet të bëhet jo më vonë se [28] ditë pas pranimit të kërkesës.
3. Oferta për të vënë në dispozicion shfrytëzimin e shërbimeve të sistemit duhet t'i përcaktojë:
  - a) Piken e kyçjes,
  - b) Kapacitetin në disponim,
  - c) Të gjitha shërbimet tjera të cilat mund të kërkohen me kërkesë, dhe
  - d) Çmimet që duhet të paguhet për shërbimet e tilla.
4. Çfarëdo marrëveshje, apo ofertë e bërë nga OST-ja duhet të jetë në pajtim me Ligjet e Kosovës, Kodin e Rrjetit, licencën apo ndonjë Rregull tjetër të lëshuar nga Rregullatori.





## PJESA IV – KYÇJA NË SISTEM

### Neni 10

#### Metodologjia për përcaktimin e taksave të kyçjes

1. Metodologjia e përcaktimit të taksave duhet të përpilohet në mënyrë të tillë me të cilën do t'u mundësohet shfrytëzuesve të sistemit që të bëjnë një vlerësim të arsyeshëm mbi taksat e kyçjes në fuqi.
2. Metodologjia e përcaktimit të taksave duhet të përfshijë:
  - a) Format e ekzemplarëve ku janë të cekura materialet e nevojshme për kyçje dhe çmimet e aseteve (përfshirë koston e punëve, ofrimin dhe instalimin e linjave elektrike, impianteve apo njehsorëve) të kostove domethënëse, të cilat mund të kërkohen për qëllime të kyçjes (në pikat hyrëse dhe dalje) të sistemit të transmetimit për të cilat mund të paguhen taksat për kyçje dhe, sipas mundësisë, përfshijnë taksa indikative kundrejt çdo pike të cekur në listë ose (nëse kjo nuk është e mundur) bazën mbi të cilën këto taksa do të llogariten;
  - b) Bazën mbi të cilën do të llogariten taksat kundrejt zgjerimit apo përforsimit të sistemit të transmetimit të cilën OST-ja vlerëson, në mënyrë të arsyeshme, se janë të domosdoshme për t'i ofruar një kyçje parashtruesit të kërkesës pa rrezikuar stabilitetin apo sigurinë e sistemit;
  - c) Bazën mbi të cilën do të llogariten taksat ku sigurimi i linjave elektrike apo impiantit që duhet të instalohet janë të kapacitetit më të madh sesa që nevojitet për nevoja të parashtruesit të kërkesës;
  - d) Bazën mbi të cilën do të llogariten taksat për mirëmbajtje dhe riparim të Aseteve të Reja të Transmetimit të instaluar për këtë kyçje;
  - e) Bazën mbi të cilën do të llogariten taksat në raport me de-energizimin e kyçjes së konsumatorit, çkyçjen nga sistemi i OST-së dhe largimin e Aseteve të Reja të Transmetimit;
  - f) Kriteret mbi të cilat merret vendimi i OST-së për të refuzuar kyçjen në sistem, të cilat do të jenë objektive dhe teknikisht dhe ekonomikisht e arsyeshme.
3. Për t'iu shmangur dyshimit, në rastet kur asetet janë paguar nga kontributet e konsumatorit, Baza e Rregulluar e Aseteve nuk do të përfshijë kontributet e konsumatorëve.
4. Metodologjia duhet të përfshijë një listë të informatave të kërkuara për kyçje në Sistemin e transmetimit, përfshirë edhe formularët të cilët parashtruesi i kërkesës duhet t'i plotësojë. Në rast të kyçjeve komplekse, OST mund të kërkojë informata shtesë nga parashtruesi i kërkesës.



5. Metodologjia e aprovuar duhet të publikohet në ueb faqen e OST/OT-së dhe duhet të jetë lehtësisht e qasshme ndërsa kopjet fizike duhet t'iu vihen në dispozicion pa pagesë parashtruesve të kërkesave të cilët nuk kanë qasje në ueb faqe zyrtare.

#### **Neni 11**

##### **Kyçja e gjeneratorit**

1. Aplikuesi për kyçje të gjeneratorit të ri apo rritjes së kapacitetit të kyçjes për gjenerimin ekzistues, duhet të paguajnë taksa për kyçje të thellë. Këto taksa duhet të përcaktohen në atë mënyrë që të mbulojnë kostot direkte për sigurimin e kyçjes në pikën më të afërt të përshtatshme në sistemin e transmetimit, përfshirë edhe matjet dhe transformatorët për ngritje, të domosdoshme për të mundësuar kyçjen, së bashku me koston e përforcimit dhe të rikonfigurimit të sistemit të transmetimit.
2. OST-së i lejohe të kërkojë pagesë, sipas Metodologjisë së Taksave për Kyçje e cila do të miratohet nga Rregullatori, me qëllim të mbulimit të kostove që kanë të bëjnë me vlerësimin e kërkesës së parashtruar nga gjeneratorët për kyçje në sistemin e transmetimit.

#### **Neni 12**

##### **Taksat për kyçje**

1. Taksat e OST-së për kyçje duhet të përcaktohen në bazë të:
  - a) Rikthimit të koston për kyçje të thellë, ku:
    - i. një ngarkesë e re apo rritja në ngarkesë tejkalon 3% të kapacitetit ekzistues efektiv në pikën e kyçjes në rrjetin e transmetimit, dhe
    - ii. kyçja nuk është paraparë në Planin zhvillimor të transmetimit, dhe
    - iii. kostot indirekte të punëve që lidhen me përforcimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues dhe të cilat janë shkaktuar si pasojë direkte e krijimit të kyçjes së re e cila tejkalon për dhjetë herë të hyrat e pritura të OST/OT-së nga taksa përkatëse për kyçje.
  - b) Rikthimi i koston për kyçje të cekët, ku:
    - i. një ngarkesë e re apo rritja në ngarkesë nuk tejkalon 3% të kapacitetit ekzistues efektiv në pikën e kyçjes në rrjetin e transmetimit, ose
    - ii. kyçja parashihet në Planin zhvillimor të transmetimit, ose



- iii. kostot indirekte të punëve që lidhen me përforcimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues dhe të cilat janë shkaktuar si pasojë direkte e krijimit të kycjes e cila nuk tejkalon për dhjetë herë të hyrat e pritura të OST/OT nga taksa përkatëse për kycje.

### **Neni 13**

#### **Përcaktimi i taksave për kycje**

1. OST/OT pas hartimit të Metodologjisë për përcaktimin e taksave për kycje, në përputhje me Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe të tregut dhe këto parime e dërgon për aprovim te Rregullatori.
2. Taksat nuk hyjnë në fuqi para se të aprovohen nga Rregullatori. Rregullatori do t'i aprovoj taksat apo do të ofroj arsye për mos aprovimin e tyre brenda 60 ditëve nga data e dërgimit të taksave të tilla te Rregullatori.

### **Neni 14**

#### **Oferta e Kushteve për kycje**

1. Në rastet kur OST ka pranuar kërkesë formale për kycje me të gjitha informatat e nevojshme sipas Metodologjisë së aprovuar për kycje në rrjetin e transmetimit, ai duhet të jep ofertë formale për të kycur parashtruesin e kërkesës brenda afateve kohore të parapara me Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
2. Oferta duhet të përmbajë datën deri kur do të përfundojnë punët e kycjes.
3. Në rastet kur OST-ja dhe parashtruesi i kërkesës pajtohen, oferta mund të përmbajë kushtet për pagesat e interesit për moskryerjen, nga cilado anë, e punëve të domosdoshme apo të ofrojnë pëlqime të domosdoshme e të cilat çojnë në vonesa dhe kosto për palën tjetër.
4. Çfarëdo marrëveshje, apo ofertë e bërë nga OST-ja duhet të jetë në pajtim me Ligjet e Kosovës, Kodin e transmetimit, licencën e tij apo ndonjë Rregull tjetër të lëshuar nga Rregullatori.



## **PJESA V - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Dispozitat kalimtare**

#### **Neni 15**

1. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij dokumenti i licencuari obligohet të dërgojë Metodologjitë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Tregut për aprovim te Rregullatori.
2. Brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij dokumenti i licencuari obligohet të dërgojë Metodologjinë e taksave për kyçje në sistemin e transmetimit për aprovim te Rregullatori.

### **Gjuha zyrtare**

#### **Neni 16**

Këto parime janë nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehen në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes mes versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

#### **Neni 17**

### **Ndryshimet**

ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të këtyre Parimeve pas procesit të konsultimit publik.

#### **Neni 18**

### **Shfuqizimi**

Këto parime shfuqizojnë “Parimet e përcaktimit të Tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Taksat e Kyçjes” të aprovuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në vitin 2012.

#### **Neni 19**

### **Interpretimi**

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e këtyre Parimeve, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.



Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u.d Kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar